



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.39, datë 27.07.2022

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“OBJEKT SHËRBIMI HOTELIER ME 7 KATE MBI TOKË DHE 1 KAT PARKIM
NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË GOLEM, BASHKIA KAVAJË

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7, shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “MARO-2017” shpk, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Objekt shërbimi hotelier me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat parkim nëntokë”, me vendndodhje në Golem, Bashkia Kavajë, me subjekt zhvillues shoqërinë “MARO-2017” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Kavajë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me marrëveshjen përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Kavajë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

